



---

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"**  
**KOMISIONI I APELIMIT**

**Rregullore e Komisionit të Apelimit (KA)**

*Bazuar në Rregulloren për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe senatin akademik në USH neni 37, pika 6, miratuar me vendimin e Senatit Akademik nr. 106, datë 20.02.2020.*

**Neni 1**

Komisioni i Apelimit (në vijim KA) shqyrton dhe merr vendime të arsyetuara, në të cilat përfshihen dhe mendimet "kundër", për çdo ankimim në lidhje me vendimet e marra prej KIZ; në votimet e KA nuk lejohet abstenimi.

**Neni 2**


KA i merr vendimet me shumicë absolute të të gjithë anëtarëve të tij. Vendimet e KA publikohen në mjediset e institucionit, ku është e vendosur selia e tij si dhe në faqen zyrtare web të USH, jo më vonë se 12 orë pas marrjes së tyre. Vendimet e KA firmosen nga të gjithë anëtaret.

**Neni 3**

Kryetari i KA thërret mbledhjen e rradhës dhe cakton rendin e ditës, perveç rasteve kur KA ka vendosur ndryshe. Ai e bën të ditur datën dhe orën e mbledhjes për të gjithë anëtarët e KA të paktën 24 orë përpara mbledhjes, e drejton mbledhjen dhe diskutimet si dhe siguron zbatimin e ligjit dhe akteve të tjera nënligjore gjatë marrjes së vendimeve. Çdo ndryshim në datën dhe kohën e vendosur për mbledhjet i njoftohet çdo anëtar i KA në të njëjtën mënyrë.

**Neni 4**

Sekretari i KA mban procesverbalin e mbledhjeve, i cili nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e KA në fund të çdo mbledhje, administron të gjithë dokumentacionin përfunkcionimin e KA. Përgatit shkresat dhe vendimet e KA. Anëtarët e KA kanë të drejtë të kërkojnë një kopje të njehsuar të të gjithë vendimeve të KA.



### **Neni 5**

Zëvendësimi i kryetarit dhe sekretarit mund të bëhet përkohësisht, përkatësisht nga anëtari më i vjetër dhe nga anëtari më i ri në detyrë.

Në rastet kur anëtarët me të drejtë vote kanë shërbyer si anëtarë për një periudhë të njëjtë kohe, zëvendësimi i përkohshëm do të bëhet përkatësisht nga anëtari me i vjetër dhe nga ai më i riut në moshë.

### **Neni 6**

Kryetari është i detyruar të thërrasë një mbledhje të veçantë kur kjo kërkohet me shkrim nga të paktën 1(një) anëtar i KA, duke përcaktuar çështjet për të cilat thirret kjo mbledhje. Mbledhja është e vlefshme kur marrin pjesë më shumë se gjysma anëtarëve të KA.

### **Neni 7**

KA merr vendime merren vetëm për çështje të cilat janë përfshirë në rendin e ditë së mbledhjes ose kur të paktën 3 (tre) anëtarë vendosin për shqyrtimin edhe marrjen e vendimeve për çështje të cilat nuk janë në rendin e ditës.

Mbledhjet janë të hapura për subjektet e parashikuara nga rregullorja e zgjedhjeve.

### **Neni 8**

Pëveç rrugëve të komunikimit zyrtar KA pranon si komunikim edhe shkresat e skanuara, dërguar nëpërmjet postës elektronike zyrtare të KA, [KA2020@unishk.edu.al](mailto:KA2020@unishk.edu.al), të cilat më pas do të bashkëshoqërohen me dokumentacionin përkatës. Selia e KA ndodhet në sallën nr. 302 (kati i tretë, godina e Rektoratit).

### **Neni 9**

Në rast konflikti mbi interpretimin e kësaj rregulloreje, KA bën interpretimin përfundimtar me shumicën absolute të votave të anëtarëve. Kjo rregullore mund të amendohet në çdo rast me propozim të kryetarit, sekretarit ose të një prej anëtarëve.

### **Neni 10**

Kur konstatohen gabime materiale në një vendim të KA, KA bën ndreqjen e gabimit me anë të një vendimi shtojcë, duke cituar gabimin material të bërë gjatë zbardhjes së vendimit, duke bërë referencën tek burimi i saktë si dhe duke specifikuar se është i njëjti vendim i manë imbl të njëjtat dokumenta të inventarizuara në dosje, gjatë kohës së shqyrtimit dhe marrjes së vendimit nga KA.

### **Neni 11**

Kjo Rregullore hyn në fuqi menjëherë.